



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 14 Janar 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1476_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 9, Nenit 12, Nenit 14, Nenit 16, Nenit 17, Shtojca 2 të Rregullës Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Njoftimin e ZRRE Nr. 497/21 të datës 12.10.2021 për ri-hapjen e procesit për shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe Shpenzimeve Operative për Furnizuesin me Shërbim Universal për periudhën 2022-2024;
- Propozimin për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative për Furnizuesin me Shërbim Universal për periudhën 2022-2024, të pranuar nga i licencuari KESCO SH.A., më datë 01 nëntor 2021 në ZRRE, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, në seancën e mbajtur më 14 janar 2022, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU) për periudhën tarifore 2022 – 2024.
- II. Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU), janë paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Vlerat Hyrëse dhe Shpenzime Operative për FSHU	Njësia	2022	2023	2024
Marzha me pakicë	%	2.54	2.54	2.54
Borxhi i keq	%	2.4	2.2	2.0
Faktori ndarës i jobalanceve	%	100	100	100
Shpenzimet operative me efikasitet	€000	5,169	5,166	5,163
Faktori i efikasitetit	%	0	0.1	0.1
Kategorizimi dhe jetëgjatësia e Aseteve:				
I. Mobicet, pajisjet për zyrë;	Vite	7	7	7
II. Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët , pajisjet TI dhe softuerë		5	5	5



- III. Ky Vendim do të zbatohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) nga data 01 prill 2022 deri në shqyrtimin e ardhshëm periodik.

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), më 12 tetor 2021 ka lëshuar njoftimin zyrtar në lidhje me ri-hapjen e procesit për shqyrtimin e vlerave hyrëse dhe Shpenzimeve Operative për Furnizuesin e Shërbimit Universal për periudhën 2022-2024, me të cilën ka njoftuar se procesi i përcaktimit të vlerave hyrëse, i cili kishte filluar më datë 10 shtator 2020, nuk ishte përmbyllur për arsye të mungesës së Bordit funksional të ZRRE-së, andaj pas kompletimit të Bordit, ZRRE ka vendosur që të vazhdoj këtë proces.
- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më 25 tetor 2021 ka publikuar Raportin Konsultativ për përcaktimin e Vlerave Hyrëse dhe Shpenzimeve Operative (OPEX) për Furnizuesin e Shërbimit Universal – FSHU, për periudhën 01 prill 2022 – 31 mars 2025.
- o ZRRE bazuar në Rregullën për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal përcakton vlerat e disa parametrave të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në përcaktimin e Të Hyrave të Lejuara të FSHU-së. Këto përfshijnë vlera të tilla si Shpenzimet Operative, Faktori i Efikasitetit, Jetëgjatësia e aseteve, Borxhi i Keq, Marzha me pakicë dhe Faktori Ndarës i Jobalanceve. Ky Raport Konsultativ paraqet propozimet fillestare të ZRRE-së për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative për periudhën e ardhshme 2022-2024 dhe publikohet me qëllim të informimit të palëve të interesit si dhe ofrimit të mundësisë së komentimit dhe paraqitjes së pikëpamjeve të palëve të interesit mbi vlerat e propozuara.
- o Procesi i përcaktimit të Vlerave Hyrëse dhe Shpenzimeve Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU), për periudhën tarifore 2022-2024, bazohet në të dhënat historike 2017 - 2021, si dhe janë marrë për bazë praktikatat rregullatore të vendeve në regjion dhe të vendeve të Evropës.
- o ZRRE përmes Raportit Konsultativ – Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimeve Operative të Furnizuesit me Shërbime Universal - Rishikimi i vlerave hyrëse (2022-2024), i ka ftuar të gjitha palët e interesit që ti paraqesin komentet e tyre me shkrim, jo më vonë se data 08 dhjetor 2021;
- o Furnizuesi me Shërbim Universal (FSHU) me datë 01 nëntor 2021 ka dorëzuar në ZRRE propozimin për Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative për periudhën 2022-2024, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike.
- o ZRRE gjatë konsultimit publik, ka pranuar komente dhe informata të rëndësishme, kryesisht nga furnizuesit me energji elektrike në Kosovë, të cilat janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar.
- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më 14 janar 2022, pas vlerësimit ka përgatitur dhe publikuar Raportin përfundimtar dhe përgjigjet ndaj komenteve të pranuar, të palëve të



interesit për Vlerave Hyrëse dhe Shpenzimeve Operative (OPEX) për Furnizuesin e Shërbimit Universal –FSHU, për periudhën 2022 – 2024.

- ZRRE ka trajtuar të gjitha komentet e palëve të interesit në lidhje me marzhën me pakicë dhe nuk ka gjetur ndonjë arsye e cila do të ndërronte propozimin fillestar të saj.
- Pas përjashtimit të kostove për mbulimin e humbjeve, marzha me pakicë, duke përfshirë edhe periudhën 2013-2016 rezulton të jetë 2.57%. Rezultatet paraqesin një dallim prej 0.03% në krahasim me vlerësimin fillestar të ZRRE-së, nga kjo konfirmohet se vlerësimi fillestar i ZRRE-së është i qëndrueshëm. Për më tepër, ZRRE sipas metodologjisë së njëjtë ka parashikuar edhe kostot e energjisë me shumicë për periudhën 2022-2024, rezultatet e të cilave konfirmojnë arsyeshmërinë e propozimit të nivelit të marzhës pas krahasimit të kostove mesatare të marzhës me kostot me shumicë.
- ZRRE në përcaktimin e marzhës me pakicë ka marrë parasysh edhe aspektet parimore rregullative si vijon: FSHU nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të volumeve të energjisë, për më tepër energjia nga KEK ofrohet me prioritet për FSHU; Blerjet që bëhen nga tregtarët barten në kostot e FSHU-së; Kostot e plota të FSHU-së njihen dhe përshtaten gjatë shqyrtimeve tarifore; dhe Analizimin e të dhënave historike, përvojave rregullatore, kushteve dhe rrethanave të operimit të Furnizuesit me Shërbim Universal.
- ZRRE ka pranuar komente nga palët e interesit në lidhje me borxhin e keq të FSHU-së dhe i ka dhënë sqarimet lidhur me vlerësimin e saj në pjesën e përgjigjeve ndaj komenteve. ZRRE nuk ka gjetur argumente shtesë nga procesi i konsultimit publik lidhur me ndryshimin e vlerësimit fillestar për borxhin e keq të FSHU-së.
- ZRRE ka pranuar komente nga palët e interesit në lidhje me faktorin ndarës të jobalanceve dhe ka dhënë përgjigje për secilin koment të pranuar, të cilat nuk kanë ofruar argumente për të ndryshuar vlerësimin fillestar të ZRRE-së. Andaj, siç është theksuar që vlerësimin fillestar faktori ndarës i jobalanceve aktualisht është përcaktuar në 100%, që do të thotë që të gjitha kostot e balancimit kalojnë te konsumatorët (qofshin ato pozitive apo negative), duke ditur që KESCO ka pak mundësi për të rregulluar blerjet e energjisë para kohe për të përmbushur kërkesën.
- ZRRE ka trajtuar komentet e palëve të interesit në lidhje me shpenzimet operative të FSHU-së. Nga rishikimi i analizës, ZRRE ka gjetur që KESCO ka arsye për trajtimin e shpenzimeve të sigurimit si kosto të pakontrollueshme. Si rrjedhojë, ZRRE ka përshtatur faktorin e efikasitetit dhe OPEX-in duke marrë në konsideratë kostot e sigurimeve si kosto të pakontrollueshme. Pas ndryshimit të trajtimit të kostove të sigurimit, ato do të përshtaten në baza vjetore për të marrë parasysh dallimet ndërmjet vlerave të lejuara dhe atyre aktuale e jo nëpërmjet faktorit të efikasitetit.
- ZRRE gjatë procesit të konsultimit publik, nuk ka pranuar komente në lidhje me kategorizimin dhe jetëgjatësinë e aseteve, prandaj vlerësimi fillestar i saj mbetet edhe propozim përfundimtar për kategorizimin dhe jetëgjatësinë e aseteve të FSHU-së, ashtu siç janë paraqitur në Raport.



- ZRRE ka vlerësuar edhe komentet e KESCO/FSHU. Në propozimin përfundimtar të Faktorit të efikasitetit ndaj shpenzimeve operative, ZRRE ka marrë në konsideratë trajtimin e shpenzimeve të sigurimit si kosto të pakontrollueshme. Në këtë kuptim, meqenëse faktori i efikasitetit aplikohet vetëm ndaj shpenzimeve të kontrollueshme të FSHU-së, kostot e sigurimit nuk janë marrë parasysh në kalkulimin e tij. Kostot e sigurimit do të trajtohen përmes azhurnimeve të rregullta sipas realizimit të tyre dhe nuk do të jenë të ndikuara nga faktori i efikasitetit.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante, pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:




Ymer Fajzullahu, kryesues



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar



Lutfije Gashi, anëtar



Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO SH.A) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.